



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:236331

Datë: 18.03.2024

Numri i dokumentit: 05464623

C-IV-15-0505

Parashtruesi i kërkesës: J S nga fshati K, Komuna e Gllogovcit

Kundër

Palës kundërshtare: Agjencia Kosovare e Privatizimit ,rruga Dritan Hoxha nr.55, Prishtinë

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, përmes gjyqtarit Asllan Krasniqi, me datën;18.03.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

1. REFUZOHET si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga J S , me të cilën ka kërkuar që të ndryshohet vendimi PRN-011-0099, i datës 11.03.2015, i lëshuar nga AKP, dhe t'i kompensohen 6 paga në shumën prej 1,015.00€, si ish punëtor i NSH Drenica (në likuidim).
2. Vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj vendimi me shkrim që evidentohet me numër PRN-011-0099 i datës:11.03.2015 i lëshuar nga AKP.
3. Secila palë i heqë shpenzimet e veta të procedurës.

Rrethanat Faktike dhe Procedurale

Me datën 23.04.2015, pranë DHPGJS, J S ka parashtruar kërkesë kundër palës kundërshtare Agjencia Kosovare e Privatizimit me të cilin ka kërkuar rishikimin vendimit me shkrim me numër PRN011-0099, të datës 11.03.2015, të lëshuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit me të cilin i ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa për kompensimin e shumës prej 1,015.00, në emër të dëmshpërblimit për shkak të ndërprerjes para kohe të marrëdhënies së punës nga NSH KB Drenica (në Likuidim). Parashtruesi i kërkesës ndër të tjera ka theksuar se vendimi i kundërshtuar është tërësisht i gabuar, i kundërligjshëm dhe skajshmërisht jo profesional. Vendimi i lëshuar nga Autoriteti i Likuidimit është në kundërshtim edhe me nenin 40 pika 1.6.2 të Shtojcës së Ligjit Nr. 04/L-034, për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Kjo për faktin se ish AKM-ja, me urdhëresë e ka ndërprerë procesi i prodhimit, veprimtarisë tregtare, hoteliere dhe ajo e bujqësisë dhe se sikur kjo ndërmarrje të mos menaxhohej nga AKM, do të realizonte një afarizëm më të mirë dhe pa asnjë problem financiar, çfarë do të ishte e mundur që punëtorëve t'iu paguheshin pagat. Me këto veprime AKP-ja –Zyra Rajonale në Mitrovicë në cilësi të organit publik qartazi i ka shkelur të drejtët e njeriut të garantuara me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore dhe Protokollet e saja, po ashtu pala kundërshtare e ka shkelur edhe nenin 7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Menaxhmenti dhe punëtorët e NSH-së, në vazhdimësi kanë kërkuar nga ish AKM-ja dhe AKP-ja pagesën e të ardhurave personale gjë që vërtetohet edhe nga kërkesat e protokolluara të cilat i janë dorëzuar palës kundërshtare.

Me tutje në kërkesën e parashtruar e ka theksuar se bazuar në Ligjin e punës neni 76 par7.4, parasheh se punëtorët të cilët kanë 20-19 vite të përvojës së punës gëzojnë të drejtën e kompensimit të 6 pagave mujore dhe se ankuesi ka mbi 2 vite të përvojës së punës. Bazuar në këtë përvojë të punës pala kundërshtare ka për detyrim kompensimin e 6 pagave, si dhe e ka kundërshtuar pretendimin e palës kundërshtare e cila ka pretenduar se kërkesa është e parashtruar.

Përfundimisht i ka propozuar gjykatës që kërkesën për rishikim të vendimit ta aprovoj në tërësi si të bazuar, ta ndryshoj vendimin e lëshuar nga pala kundërshtare dhe të detyrohet e njëjta që parashtruesit të kërkesës t'ia kompensoj 7 paga mujore në emër të dëmshpërblimit për shkak të ndërprerjes së marrëdhënie së punës me kamatë prej 10 % në vit, në kuptim të nenit 37 të Ligjit Nr.04/L-034, për Agjencinë Kosovare të Privatizimit; apo ta prishë vendimin e lëshuar nga Autoriteti i Likuidimit dhe çështjen ta kthej në rivendosje pranë Autoritetit të Likuidimit.

Kësaj kërkesë parashtruesi si provë i ka bashkëngjitur:

- *Vendimin e nxjerrë nga Agjencia Kosovare e Privatizimit me numër PRN011-0034;*
- *Vendimin për caktimin e kategorive të vendeve të punës;*
- *Njoftimin për ndërprerje të marrëdhënie së punës;*

Me datën 29.12.2023, AKP-ja përmes përfaqësuesit të sajë ka paraqitur mbrojtjen e saj ndaj kërkesës së parashtruar nga J S ,ku ndër të tjera ka theksuar se NSH Drenica (në likuidim), ka hyrë në procedurën e likuidimit me datës 09.06.2014, dhe se i njëjti me datën 25.07.2014, ka parashtruar një kërkesë për kompensimin e shumë prej 1,015.00 €, në emër të dëmshpërblimit për shkak të ndërprerës së marrëdhënie së punës në ndërmarrje.

Autoriteti i Likuidimit e ka shqyrtuar kërkesën e parashtruar nga J S në atë procedurë dhe me vendimin që evidentohet me numër PRN011-0099, të datës 13.03.2015, kërkesën e parashtruar nga i njëjti e ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar. Vendimin në lidhje me refuzimin e kërkesës e parashtruar nga J S e ka bazuar në nenin 36.2 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 dhe nenin 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar.

Me tutje në mbrojtjen e parashtruar pala kundërshtare ka theksuar se Autoriteti i Likuidimit me rastin e vendosjes ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se saktë i ka zbatuar edhe dispozitat ligjore. Objekt i kësaj çështje juridike është ligjshmëria e vendimit kontestues dhe se parashtruesi i kërkesë nuk ka provuar se cila dispozitë e Ligjit Nr.04/L-034 është shkelur nga ana e Autoritetit të Likuidimit, me rastin e vendosjes në kërkesën e parashtruar nga i njëjti. Bazuar në nenin 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034 për Agjencinë Kosove të Privatizimit, Autoriteti i Likuidimit ka kryer vlerësim të saktë të kërkesës dhe ka ardhur në përfundimin se kërkesa është e pa vlefshme.

Po ashtu kërkesa e parashtruar nga parashtruesi i kërkesës është e parashkruar konform nenit 608 të Ligjit për Punën e bashkuar, ligj i cili është i aplikueshëm me nenin 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr.1999/24. Me këtë nen është e përcaktuar se pagesa e shumës së pagës-rrogës, ose ndonjë kërkesë tjetër të punëtorëve që rrjedh nga marrëdhënia e punës parashkruhen për tri vite. Në këtë kontekst kërkesa e parashtruesit të kërkesës do të duhej të parashtrohej në gjykatë apo në ndonjë organ tjetër kompetent brenda tri viteve nga momenti kur NSH-ja, nuk ka përmbushur ndaj ankuesit ndonjë kërkesë të rrjedh nga marrëdhënia e punës. Në rastin konkret Autoriteti i Likuidimit ka ardhur në përfundimin se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është e parashkruar ngase i njëjti nuk ka marrë asnjë veprim për ta ndërprerë rrjedhën e afatit të parashkrimit që nga viti 2000.

Përfundimisht i ka propozuar gjykatës që kërkesën e parashtruar nga parashtruesi i kërkesës ta refuzoj si të pa bazuar në pajtim me nenin 54.1 të Ligjit nr.06/L-086; dhe të vërtetohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit në pajtim me nenin 74.4 të Ligjit Nr.06/L-086.

Arsyetimi Ligjor

Në bazë të nenit 76 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-086 të DHPGJS në lidhje me nenin 399 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore të Kosovës, gjykata përcakton se faktet relevante të rastit janë të pakontestueshme dhe nxjerrë këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore. Pas shqyrtimit të provave të lëndës parashtrimeve dhe pretendimeve të palëve në procedurë gjykata ka ardhur në përfundimin se kërkesa e parashtruar në këtë çështje juridike është e pa bazuar.

Objekt i shqyrtimit nga gjykata ishte kërkesa e parashtruesit të saj i cili ka pretenduar se si ish punëtor i NSH KB Drenica, i takon kompensimi prej 6 pagave duke u mbështetur në Ligjin e Punës, i cili është në zbatim. I njëjti e ka kontestuar vendimin e nxjerrë në Autoriteti i Likuidimit, me pretendimin se vendimi i nxjerrë është në kundërshtim me dispozitat ligjore e po ashtu nuk është vërtetuar drejtë gjendja faktike. Në anën tjetër pala kundërshtare përmes mbrojtjes ka pretenduar Autoriteti i Likuidimit me rastin e vendosjes ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se saktë i ka zbatuar edhe dispozitat ligjore dhe se në rastin konkret kërkesa e pretenduar e parashtruesit të kërkesës është e parashkruar. Pas shqyrtimit të pretendimeve, parashtrimeve dhe provave të lëndës gjykata ka gjetur se parashtruesi i kërkesës me datën 25.07.2014, ka parashtruar një kërkesë pranë Autoritetit të Likuidimit, përmes së cilës ka kërkuar kompensimin e shumës prej 1,015.00 €, në emër të pagave si ish punëtor i NSH Drenica (në Likuidim).

Pala kundërshtare e ka shqyrtuar kërkesën e parashtruar dhe me vendimin me numër PRN011-0099, e ka refuzuar kërkesën për kompensimin e shumës së kërkuar për shkak të parashkrimit të kërkesës. Nga provat e shqyrtuara gjykata ka gjetur se parashtruesi i kërkesës ka kërkuar kompensimin e pagave për vitet 2010 ndërsa kërkesën pranë Autoriteti të Likuidimit e ka parashtruar me datën 25.07.2014, pas kalimit të afatit prej 3 viteve.

Rrjedhimisht duke u bazuar në nenin 376 paragrafi 1 të LMD-së (1978) e cila dispozitë në mënyrë shprehimore përcakton se “kërkesa e shpërblimit të dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri vjet nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe për personin që e ka bërë dëmin”, gjykata ka ardhur në përfundimin se kërkesa e pretenduar e parashtruesit të kërkesës për kompensim të pagave është e parashkruar.

Shpenzimet Gjyqësore:

Në bazë të nenit 62 paragrafi 5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës secila palë do ti heqë shpenzimet e veta.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, brenda 15 ditësh, llogaritur nga data e pranimi të këtij aktgjykimi.

Gjyqtari;
Asllan Krasniqi